

## **Plani vjetor dhe strategjik i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në “Albpetrol” sh.a. Patos**

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm, nëpërmjet këtij materiali paraqet Planin Vjetor të vitit 2023, si dhe Planin Strategjik 2023-2025, të përgatitur në përputhje me detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën c të nenit 14 të ligjit nr.114, datë 25.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe në Kapitullin III “Planifikimi i veprimtarisë të Auditimit të Brendshëm” të Manualit të Auditimit të Brendshëm, konkretisht Standarti 2010-Planifikimi ku citohet:

*“Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të vendosë një plan auditimi të bazuar në rrezik për të përcaktuar përparësitë e aktivitetit të auditimit të brendshëm, në lidhje me synimet e organizatës”.*

### **• Qëllimi i Planit Strategjik dhe Misioni i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm**

Qëllimi i Planit Strategjik 2023-2025 është të përcaktojë drejtimet në të cilat do të zhvillojë aktivitetet Drejtorja e Auditimit të Brendshëm për tre vitet e ardhshme, me qëllim kryerjen sa më të plotë të misionit të saj që është:

- *Të japë siguri të arsyeshme, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe të bazuar në vlerësimin e riskut për Këshillin Mbikqyrës të kompanisë “Albpetrol” sh.a, Administratorin e kompanisë, si dhe të gjithë drejtuesve të niveleve të ndryshme të kompanisë se po arrihen objektivat e përcaktuara në dokumentat strategjike të kompanisë, nëpërmjet:*
- *Vlerësimit të ekzistencës dhe përputhshmërisë me ligjin të elementëve të kontrollit të brendshëm, të procedurave, rregulloreve, dokumentave strategjik, administrativ dhe operacional.*
- *Vlerësimit të ekzistencës, përputhshmërisë me ligjin dhe saktësisë e besueshmërisë së hartimit të raporteve financiare, administrative, operacionale dhe të performancës të përgatitura nga të gjitha strukturat e kompanisë për nivelet e ulta të menaxhimit dhe deri te Administratori dhe Këshilli Mbikqyrës.*
- *Vlerësimin e ekzistencës apo jo të mundësisë për mashtrim, humbje dhe keqpërdorim të burimeve materiale dhe monetare të kompanisë.*
- *Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në kompaninë “Albpetrol” sh.a.*

### **• Organizimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe Kuadri ligjor**

Njësia e Auditimit të Brendshëm e shoqërisë “Albpetrol” sh.a sipas strukturës është emërtuar Drejtori dhe përbëhet nga Drejtori, Kryespecialisti dhe 4 (katër) specialist. Kjo strukturë është miratuar me vendim nr.19, datë 03.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë.

Përbërja profesionale e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm momentalisht paraqitet si më poshtë:

1. Edlira Podgorica me detyrë Drejtor, ka kryer studimet e larta për Master Shkencor në Shkencat Sociale dhe Master Shkencor në Drejtësi, e çertifikuar si “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik” me eksperiencë pune 10 vjet dhe mbi 9 vjet si auditues.
  2. Arjan Haxhiraj me detyrë Kryespecialist auditi, ka kryer studimet e larta për Ekonomi Financë, i çertifikuar si “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik” me eksperiencë pune 27 vjet dhe mbi 18 vjet si auditues.
  3. Lonidha Mitro me detyrë specialist auditi, ka kryer studimet e larta për Financë - Kontabël, i çertifikuar si “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik” me eksperiencë pune 27 vjet dhe mbi 12 vjet si auditues.
  4. Arben Moçi me detyrë specialist auditi, ka kryer studimet e larta për Inxhinieri, i çertifikuar si “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik” me eksperiencë pune mbi 34 vjet, dhe mbi 4 vite pune në detyrë si audit.
  5. Endrit Shehaj me detyrë specialist auditi, ka kryer studimet e larta për Drejtësi, i çertifikuar si “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik”, eksperiencë punë 11 vjet dhe mbi 9 vjet si auditues.
- Theksojmë se nga muaji Qershor 2019 deri në datë 3 Tetor 2022, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm nuk ka pasur të emëruar Drejtorin e Drejtorisë, ndërsa nga muaji Korrik 2021 e në vazhdim sipas strukturës së miratuar ka mungesë në personel dhe të një specialisti auditimi.

### Kuadri Ligjor

Baza Ligjore mbi të cilën ushtron aktivitetin Drejtoria e Auditimit në “Albpetrol” sh.a. bazohet tek ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” I ndryshuar, Ligji nr.7746, datë 28.08.1993 “Për kërkimin, zhvillimin, prodhimin, trajtimin, transportin dhe shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze brënda dhe jashtë RSH”, i ndryshuar, ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligji nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar, ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH” i ndryshuar, ligji nr.7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në RSH”, ligji nr.9136, datë 11.08.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në RSH”, me ndryshime, ligji nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës në RSH” i ndryshuar, Ligji nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, ligji nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet” me ndryshime, ligji nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime, VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, aktet nënligjore të dala në zbatim të marrëveshjeve hidrokarbure, akte të tjera ligjore dhe nënligjore të dala në fushën tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, prokurimeve publike, sponsorizimeve, punimeve të ndërtimit dhe mbikqyrjes së tyre etj. Gjithashtu,

veprimtaria e Drejtorisë është bazuar dhe në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe urdhërat e Administratorit të shoqërisë.

### **Objektivi strategjik**

Objektivi strategjik i DAB është njohja e mirë e veprimtarisë në lidhje me operacionet hidrokrabure të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. duke përcaktuar risqet që mund të ndodhin, me qëllim mënjanimin apo mbajtjen e tyre nën kontroll, në mënyrë që të shtojë vlerën në aktivitetin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. duke përdorur një metodologji auditimi në përputhje me Kuadrin e Praktikave Profesionale të Auditimit të Brendshëm.

#### **• Identifikimi i subjekteve**

Për të hartuar Planin Strategjik dhe atë Vjetor, DAB ka përdorur dy mënyra:

a) Mënyrën strukturore që realizon identifikimin e subjekteve për t’u audituar nisur nga struktura organizative e shoqërisë dhe si të tilla:

“Albpetrol” sh.a. ka gjithsej 10 Qendra vartëse, si dhe Administratën në përbërje të së cilës janë 15 drejtori, pra në total janë 11 subjekte për t’u audituar.

Qendrat e kompanisë janë Qendra e Prodhimit të Naftës Fier, Qendra e Prodhimit të Naftës Gorisht, Qendra e Prodhimit të Naftës Kuçovë, Qendra e Adiministrimit të Shitjes së Naftës e Gazit Patos, Qendra Mekanike e Naftës Kuçovë, Qendra e Furnizimit e Transportit Patos, Qendra e Emergjencave Mjedisit të Naftës e Gazit Patos, Qendra e Furnizimit e Shërbimeve Elektrike Patos, Qendra e Administrimit e Kontrollit të Pronës Patos, Qendra e Shërbimeve Gjeofizike Patos.

Nisur nga fakti se aktiviteti bazë dhe më kryesor zhvillohet nga këto Qendra, si dhe për shkak të riskut të lartë operacional që paraqesin i cili ndikon direkt në riskun financiar të shoqërisë, 7 nga këto Qendra (Q.P.N. Gorisht, Q.P.N. Fier, Q.P.N. Kuçovë, Q.A.SH.N.G. Patos, Q.E.M.N.G. Patos, Q.F.T. Patos, Q.F.SH.E. Patos) janë të vlerësuara me risk të lartë dhe janë të parashikuara çdo vit për t’u audituar, ndërsa 3 Qendra të tjera janë parashikuar të auditohen një herë në 2 vjet.

b) Mënyrën funksionale sipas të cilës identifikojmë fusha apo sisteme të ndryshme brenda njësive operacionale strukturore, të cilat paraqesin risk të lartë apo janë të lidhura ngusht me objektivat strategjike të shoqërisë dhe si të tilla kemi identifikuar:

- Identifikimin dhe trajtimin e risqeve ekonomike dhe operacionale me ndikim negativ në arritjen e sukseshmërisë së veprimtarisë së shoqërisë.
- Rritjen e numrit të puseve aktive duke riaktivizuar pusët e fondit të ndalur dhe shërbimeve në pusët ekzistuese, me synim lidhjen e marrëveshjeve hidrokrabure me investitorë që plotësojnë kushtet e kapaciteteve teknike dhe financiare për kërkimin dhe/ose zhvillimin e këtyre vendburimeve.
- Implementimin e teknologjisë së pompave me burmë në vendburimet me kapacitete të larta të fluidmarrjes dhe me pritshmëri të lartë prodhimi

#### **• Identifikimi i fushave /sistemeve prioritare**

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm ka gjithsej 11 subjekte të varësisë, për të cilat pasi identifikon risqet kryen shërbimin e auditimit të brendshëm. Fushat më me risk të shoqërisë janë dokumentimi

i prodhimit dhe shitjes së naftës, vlerësimi periodik për debitorët dhe kreditorët, zbatimi i kontratave për mallra e shërbime nga furnitorët si dhe shlyerja e detyrimeve ndaj tyre me qëllim eliminimin e penaltiteteve, zbatimi i investimeve të kryera dhe efektiviteti i kryerjes së tyre, sistemi i prokurimeve, vlerësimi i sistemeve për evidentimin dhe kthimin e aseteve të kompanisë të zëna padrejtësisht nga të tretët, sistemi i pagave, sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe lëvizjet e pa argumentuara të burimeve njerëzore, zbatimi i Marrëveshjes së hidrokarburave me konçensionarët.

- **Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve**

Plani strategjik i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit është parashikuar për tre vitet e ardhshme. Bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve për periudhën 2023-2025 janë parashikuar të auditohen të gjitha Qendrat vartëse të kompanisë “Albpetrol” sh.a. duke i vlerësuar me risk të lartë dhe të mesëm.

- **Kufizimet e Auditimit**

Kufizimet e mundshme që mund të pengojnë arritjen e objektivave të DAB janë:

- Ndryshimet e shpeshta menaxheriale apo strukturore;
- Ndërhyrjet në pavarsinë e stafit të DAB.
- Kualifikimi i duhur dhe profesional i stafit të DAB;

- **Prioritet për vitet**

Prioritetet për 3 (tre) vitet e ardhshëm të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në lidhje me përmirësimin e punës audituese janë:

- Të auditojë njësitë organizative sistemet dhe proceset e punës të shoqërisë “Albpetrol” sha në intervale të caktuara kohore, për të përcaktuar nëse janë efektive në realizimin e funksioneve të tyre të planifikimit, organizimit, drejtimit dhe kontrollit për arritjen e objektivave të përcaktuara në përputhje me objektivat e shoqërisë, misionin e saj, procedurat dhe udhëzimet e menaxhimit, si dhe standartet e performancës të vendosura.
- Të shprehet mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
- Të vlerësojë nëse risqet identifikohen dhe janë përcaktuar masa për menaxhimin e tyre
- Të shqyrtojë besueshmërinë dhe integritetin e informacionit, si dhe mjetet e përdorura për të identifikuar, matur, klasifikuar dhe raportuar atë.
- Të shqyrtojë rregullat e vendosura për ruajtjen e aseteve dhe verifikimin e ekzistencës së tyre.
- Të vlerësojë eficiencën dhe ekonomikitetin me të cilat burimet janë shpërndarë dhe përdorur
- Të identifikojë fusha/sisteme që kanë mundësi për përmirësimin e performancës së tyre dhe të rekomandojë veprime apo masa për përmirësim.
- Me kërkesë të Këshillit Mbikqyrës dhe/ose Administratorit të shoqërisë të kryejë verifikime, analiza dhe këshillime në funksion të arritjes së objektivave menaxheriale.

## **PLANI VJETOR**

Plani i auditimeve që ju paraqitet ka për qëllim:

*Të bëjë prezent para nivelit të lartë të menaxhimit të subjektit, në mënyrë të saktë dhe objektive, nëse subjekti dhe strukturat janë duke funksionuar në mënyrë të rregullt dhe nëse veprimtaria e tyre garanton realizimin e objektivave të miratuara, duke siguruar një drejtim dhe zhvillim me efektivitet të funksioneve, si dhe maksimizimin e fitimit të shoqërisë, nëpërmjet vlerësimit të saktë dhe me përgjegjësi të zbatimit të ligjit, akteve nënligjore, rregulloreve të brendëshme etj.*

Planifikimi është kryer duke argumentuar të gjitha çështjet që lidhen me veprimtarinë vjetore të auditimit, si dhe arsyetimin mbi të cilin është bazuar zgjedhja si risku, frekuenca midis dy auditimeve, shqetësimet e menaxhimit, prioritetet e institucionit, si dhe rezultatet e eksperiencës së auditimit bazuar në auditimet e mëparshme.

Plani Vjetor mbulon me auditim periudhën nga 1 Janari deri në 31 Dhjetor 2023.

- **Zhvillimet aktuale të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm**

Drejtoria e Auditit të Brendshëm është pjesë e strukturës së “Albpetrol” sh.a. dhe ka varësi organizative dhe funksionale nga Këshilli Mbikëqyrës. Struktura është e miratuar me 1 (një) Drejtor, 1 (një) Kryespecialist dhe 4 (katër) specialist, aktualisht DAB ka 1 (një) Drejtor, 1 (një) Kryespecialist dhe 3 (tre) specialist, të cilët janë të çertifikuar si “Auditues të brendshëm në sektorin publik”. Prej tyre 2 janë të profilit pwr drejtswsi, 2 auditë janë të profilit ekonomi-financë dhe 1 është i profilit inxhinieri.

Për vitin 2022 janë planifikuar 12 angazhime auditimi nga të cilat 7 auditime kanë përfunduar, 2 auditime janë realizuar me urdhër nga Administratori dhe 5 auditime janë në proces. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2022, stafi i DAB ka pasur mungesa për shkak të mosplotësimit të strukturës së miratuar për dy punonjës dhe për shkak sëmundjesh dhe të prekur nga Covid-19 të dy specialistëve, gjë që ka sjell dhe vonesa në realizimin e angazhimeve të auditimit.

- **Prioritetet e auditimit për vitin 2023**

Veprimtaria audituese e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 do të përqëndrohet në fushat prioritare do të jenë:

- Të auditoi sistemet dhe proceset e punës të shoqërisë “Albpetrol” sha në përputhje me praktikatat më të mira profesionale sipas standarteve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm;
- Të shprehet mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
- Të vlerësoi nëse risqet identifikohen dhe janë përcaktuar masa për menaxhimin e tyre

- Të shqyrtoi rregullat e vendosura për ruajtjen e asetëve dhe verifikimin e ekzistencës së tyre.
- Bashkëpunimi profesional me subjektet e audituara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

- **Objektivi kryesor për vitin 2023**

Të ndihmoi kompaninë “Albpetrol” sh.a në vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet kryerjes së auditimeve nëpërmjet të cilit do të arrihej vlerësimi i:

1. Niveli i funksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme;
2. Sistemit të evidentimit të prodhimit dhe shitjes së naftës e gazit;
3. Sistemit të përdorimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe burimeve njerëzore;
4. Dhënien e rekomandimeve për arritjen e objektivave dhe përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në kompaninë “Albpetrol” sh.a

- **Programimi i llojit të angazhimeve**

Për vitin 2023 në “Albpetrol” sh.a. janë planifikuar për t’u zhvilluar gjithsej 12 auditime: 8 Qendra vartësie, 4 auditime në sisteme të veçanta.

- **Planifikimi i kostos për vitin 2023**

Llogaritja e buxhetit të auditimit është kryer në mënyrë të përafërt duke marrë parasysh të dhënat aktuale mbi numrin e audituesve sipas strukturës së miratuar, si dhe treguesit aktualë mbi pagat dhe shtesat, sigurimet shoqërore, shpenzimet për udhëtime e dieta, internet, energji elektrike dhe kancelari.

Nr.	Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të DAB	Plani (lekë)
I	Buxheti gjithsej	8,502,080
1	Paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore	8,002,080
2	Shpenzime udhëtimi & dieta	300,000
3	Të tjera (kancelari)	200,000
4	Numri i punonjësve	5
	Kosto për person (I/4)	1,700,416

Në bazë të llogaritjes, kosto për person për vitin 2023 me treguesit e parashikuar është 1,700,416 lekë. Buxheti në total për vitin 2023 është parashikuar 8,502,080 lekë me strukturë organike të plotësuar, të cilin duke e krahasuar me vitin 2022 kemi një ulje prej 1,614,720 lekë, për shkak se parashikimi i fondit të pagave është bërë për punonjësit që janë në punë aktualisht.

- **Planifikimi i burimeve për vitin 2023**

Në vijim jepet një parashikim i burimeve të auditimit në ditë njerëz bazuar në një bilanc të menaxhimit të burimeve të auditimit njerëz dhe ditë pune në dispozicion për vitin 2023. Llogaritja është kryer bazuar në ditë pune të vlefshme në vit pa pushimet vjetore dhe festat zyrtare, si dhe njerëz auditues që janë të miratuar në strukturën e stafit të Drejtorisë së Auditimit për vitin 2023.

Nga koha efektive e punës në ditë/njerës, janë zbritur ditë njerëz që nevojiten për pushimet vjetore, festat zyrtare, pushimet javore, pushime për arsye shëndetësore, trajnime dhe angazhime të tjera si takime, mbledhje etj.

Më konkretisht të dhënat janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të DAB	Ditë për tregues	Përlllogaritja e Burimeve
1	Koha maksimale e vlefshme	260	1300 (52 javë x 5 ditë x 5 persona)
2	Pushime vjetore	20	100 ditë (4 javë për person)
3	Ditë pushimi (Festa zyrtare)	14	70 ditë (14 ditë për person)
4	Pushime për arsye shëndetsore	10	50 ditë (10 ditë për person)
5	Angazhime në trajnime	5	25 ditë (5 ditë për person)
6	Angazhime në mbledhje/takime	5	25 ditë (5 ditë për person)
7	Rezerva të planifikuara (të papritura)	5	25 ditë (5 ditë për person)
	<b>TOTALI</b>	<b>201</b>	<b>1005 ditë gjithsej</b>

Bazuar në llogaritjet e bëra garantohej realizimi i planit të auditimeve për vitin 2023 me një ngarkesë të plotë të gjithë punonjësve të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.

- **Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim**

Për rritjen profesionale të strukturës së auditimit është planifikuar një kohë prej 5 ditë për secilin auditues, kjo sipas identifikimit të nevojave për trajnim të secilit auditues si dhe duke marrë parasysh mundësinë e tyre në ndjekjen e trajnimeve. Gjithashtu ky planifikim është bazuar dhe në trajnimin e detyrueshëm ligjor që kanë audituesit e çertifikuar.

Nr.	Tematika e identifikuar për trajnim	Pjesëmarrës në trajnim (nr. personave)	Periudha (gjatë vitit)	Kohëzgjatja e trajnimit (në ditë)
1	Auditim për sistemin e detyrimeve të prapambetura	5	6 - mujori i I-rë	1
2	Auditim për sistemin e shitjeve me ankand	5	6 - mujori i I-rë	2
3	Auditim për sistemin e prokurimeve	5	6 - mujori i I-rë	2
4	Metodat dhe teknikat e auditimit	5	6 - mujori i II-të	2
5	Sistemi i teknologjisë së informacionit	5	6 - mujori i II-të	1
6	Auditim i performancës	5	6 - mujori i II-të	2

- **Sigurimi i brendshëm i cilësisë**

Sigurimi i cilësisë, bazuar në Standartin 1300, është konsideruar si kërkesë e domosdoshme për të identifikuar objektivisht mangësitë, përmirësimet që duhen bërë dhe masat efektive që duhen marrë për përmirësimin e punës në të ardhmen, në mënyrë që të sigurohet një cilësi sa më e lartë e punës audituese dhe njëkohësisht t'i shërbejë kompanisë “Albpetrol” sh.a. për t'u njohur me transparencën e përdorimit dhe administrimit të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Sigurimi i cilësisë për materialet e auditimit do të realizohet në proces të vazhdueshëm monitorimi dhe rishikim gjatë çdo angazhimi auditimi nga Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, konform kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në Kapitulli VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm” të Manualit të Auditimit të Brendshëm.